




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep:		Nr Prot:	
Dep:	03-02 / DPK	Br Prot:	01-72 / 16
Nr. Iftau:		Data:	
Broj stranica:	02	Datum:	12-01-2016
Nr. pages:			
PUNISHTINE			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.01.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-3967/15, për z. Necmedin Morina – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Mamushës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, për z. Necmedin Morina – Anëtar i Kuvendit të Komunës së Mamushës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.**

Zyrtari i lartë z. Morina është hetuar për konflikt interesi për shkak se krahas funksionit publik të këshilltarit komunal, ka qenë edhe pronar aktiv në biznesin privat N.P.T. “ARKIN Komerc”.

Agjencia kundër Korrupsionit fillimisht zyrtarit i ka dërguar shkresën njoftuese për fillimin e procedurës për shqyrtimin e konfliktit të interesit, pas së cilës është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë.

z. Morina është njoftuar se nuk mund të menaxhoj biznesin privat dhe njëkohësisht të ushtroj funksionin e zyrtarit të lartë. Ai ka deklaruar se do t'i transferojë të drejtat e menaxhimit të biznesit te ndonjë person i besuar, në mënyrë që të vazhdoj ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë z. Morina ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilën vërtetohet se ka caktuar një person të besuar për të menaxhuar biznesin privat “ARKIN Komerc”, ndërsa tani është pronar pasiv i këtij biznesi. Me këtë ai ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

